

VENDIM
Nr. 162, datë 21.3.2018

PËR PAGESËN E PJESËMARRJES NË KURSET E FORMIMIT PROFESIONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punëkërkuessit e papunë, të cilëve u është ofruar dhe kanë pranuar të marrin pjesë në një kurs të formimit profesional (kurse profesionesh), mund të përfitojnë një pagesë pjesëmarrjeje në kurs, në masën 50% të së ardhurës nga papunësia, me kusht që ata të mos përfitojnë gjatë kësaj periudhe ndihmën ekonomike ose pagesën e papunësisë.

2. Pagesa jepet për ndjekjen vetëm të një kursi, gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.

3. Punëkërkuessit e papunë, sipas pikës 1, përfitojnë një herë të vetme nga ky program.

4. Në zyrën e punësimit ngrihet komisioni i vlerësimit, i përbërë nga, të paktën, tre persona, i cili vlerëson rast pas rasti punëkërkuessit të cilët do të marrin këtë pagesë, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren përkatëse, të përcaktuar në pikën 11, të këtij vendimi.

5. Pagesa kryhet nga zyra përkatëse e punësimit, pas dërgimit të një konfirmimi nga institucioni ofrues i kursit që pjesëmarrja në programin e formimit profesional është e rregullt.

6. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit informojnë çdo muaj drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror për personat që kanë përfituar nga programet e formimit profesional, shoqëruar me listën emërore dhe programin nga i cili kanë përfituar.

7. Në rastet kur vendbanimi i punëkërkuessit të papunë është mbi 2 km larg institucionit ofrues të kursit të formimit profesional, zyra e punësimit paguan një kosto mujore transporti, në masën e përcaktuar në kuadrin ligjor për tarifën e transportit të udhëtarëve.

8. Financimi i këtij programi mbulohet nga fondet vjetore të buxhetit të shtetit, zëri "Nxitja e punësimit", miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

9. Shërbimi Kombëtar i Punësimit monitoron ecurinë e programit dhe përgatit raporte vjetore, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, të cilat ia paraqet strukturës së ndihmës shtetërore në ministrinë përgjegjëse.

10. Programi të fillojë të zbatohet gjatë vitit 2018 dhe kohëzgjatja e tij të jetë 5 (pesë) vjet.

11. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit për mbikëqyrjen e zbatimit të programit dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për nxjerrjen e rregullores së komisionit të vlerësimit dhe të kriterëve të miratimit të pagesës në zbatim të programit, nëpërmjet strukturave në varësi të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama